



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

ANKESAT E PUBLIKUT

Ankesat vlerësuar bazuar mbi Kodin e Transmetimit.

Publiku shqiptar prej dekadash gëzon një përvojë të gjatë në fushën e transmetimeve. Por mund të ndodhë që secili prej jush ndonjëherë të shohë në TV apo të dëgjojë në Radio një program në të cilin po çënohen parimet etike, dicka që ju e vlerësoni si ofendues apo që është e dëmshme.

Në cdo rast të tillë Këshilli i Ankesave merr një ankesë nga një shikues apo dëgjues, dhe e vlerëson atë në bazë të Kodit të Transmetimit, për të parë nëse ajo ka nevojë për shqyrtime të mëtejshme. Kodi i Transmetimit i ka të mirëpërcaktuara standardet dhe rregullat etike për emisionet radiofonike dhe televizive dhe subjektet audiovizive duhet t'i ndjekin këto rregulla.

Rreth Kodit të Transmetimit

Këto rregulla nuk përcaktojnë vetëm parimet etike që kanë të bëjnë me respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, me respektimin në mënyrë të nderueshme të të drejtave të të miturve, respektimin e privatësisë, dinjitetit etj., por gjithashtu ato përfshijnë dhe fusha të tjera që kanë të bëjnë me rregullimin e veprimtarisë audiovizive në tërësi të subjekteve.

Për shembull, Kodi ka rregulla mbi atë se çfarë përmbajtje duhet të ketë në TV para orës 21:00.

Nëse ne konstatojmë se një program televiziv i ka thyer këto rregulla në shkelje të Kodit të Transmetimit, atëherë AMA do ta publikojë këtë vendim.

Në raste edhe më serioze, ne ndërmarrim veprime të mëtejshme (p.sh. penalizimi i subjektit).

EMRI: _____

MBIEMRI: _____

ADRESA: _____

E-MAIL: _____

NR. TELEFONI: _____

OBJEKTI I ANKESËS: _____

NGARKONI LINKUN: _____

DATA/ORA E TRANSMETIMIT: _____

MEDIA KU ËSHTË TRANSMETUAR: _____

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin për mbrotjen e të dhënave personale. Për sqarime më të detajuara kontaktoni AMA-n ose koordinatorin e të drejtës për informim në AMA.